



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE
KORÇE

Nr. 343 Regj. Them
Data e Regj: 02.03.2015

Nr.265 Vendimi
Data:25.05.2015

V E N D I M

NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Korçe e perbere nga:

SOKOL IBI - Gjyqtar

Asistuar prej sekretares Marinela Rushi, pasi shqyrtoi ne seance gjyqesore publike, sot me date 25.05.2015, çeshtjen administrative me Nr.343 Regj.Them, qe i perket paleve ndergjyqese:

PADITES: “Fashion Woman Stores” sh.p.k, me seli ne Korçe, e perfaqesuar ne gjykim nga perfaqesuesja ligjore Ida Helmesi, si dhe nga Av:Olsi Manosopi me Nr.2945 liçense, Dhoma e Avokatise Korçe.

I PADITUR: 1. **Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe**, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Mirela Veriga dhe Avokate e Shtetit Eva Saraçi;
2. **Drejtoria e Apelimit Tatimor**, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim nga Mirela Veriga dhe Avokate e Shtetit Eva Saraçi.

OBJEKTI: 1. Konstatimin e pavlefshmerise absolute te aktit administrativ “Njoftim vleresimi Nr.17831 Prot, date 29.09.2014 per detyrimet tatimore” (gjobe per mosleshim te kuponit tatimor) vendosur nga DRT-Korçe, duke e anuluar ate.
2. Anullimin e vendimit Nr.28531/1 Prot, date 29.01.2015 te Drejtorise se Apelimit Tatimor.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32, 154 i K.Pr.Civile, nenet 58 e vijues te ligjit Nr.9920, date 19.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne R.SH”, udhezimi Nr.24, date 02.09.2008, ligji Nr.10279, date 20.05.2010, nenet 116-131 e vijues te K.Pr.Administrative, ligji Nr.49/2012.

Ne perfundim te gjykimit, gjykata pasi shqyrtoi provat ne teresi, ne konkluzionet perfundimtare pala paditese perfundimisht kerkoi pranimin e padise, pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korce dhe Drejtoria e Apelimit Tatimor perfundimisht kerkoi rrezimin e padise,

VEREN

Se paditesi “Fashion Woman Stores” sh.p.k eshte nje shoqeri tregetare me seli ne qytetin e Korçes e cila e ushtron aktivitetin e saj ne fushen e tregetimit me shumice dhe pakice te veshjeve dhe aksesoreve qe kane lidhje me to.

Ne daten 06.09.2014 inspektoret e verifikimit ne teren prane Drejtorise Rajonale Tatimore Korce kane shkuar tek vendi i ushtrimit te aktivitetit tregetar nga pala paditese ne qytetin e Korces ne baze te urdherit te punes me Nr.4478 Prot, date 06.09.2014.

Gjate inspektimit ne kete subjekt tregetar inspektoret e verifikimit ne teren te pales se paditur kane konstatuar se pala paditese (punonjesja e saj) ka kryer shitje produktesh pa e pajisur klientin qe ka blere produktin me kuponin tatimor.

Menjehere me pas inspektoret e pales se paditur kane hartuar procesverbalin e konstatimit te kundravajtjes administrative me Nr.0411652, ku e kane pasqyruar kete fakt dhe me pas kane hartuar procesverbalin e denimit me gjobe te pales paditese per kryerjen e kundravajtjes administrative te mosleshimit te kuponit tatimor te parashikuar nga neni 122 i ligjit Nr.9920, date 19.05.2008 duke vendosur denimin e pales paditese me gjobe ne masen 200.000 (dyqind mije) leke.

Nepermjet aktit administrativ “Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore” Nr.17831 Prot, date 29.09.2014 pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe ka njoftuar palen paditese per detyrimin e saj per te paguar shumen prej 200.000 leke si gjobe per mosleshim te kuponit tatimor.

Sapo pala paditese vjen ne dijeni te ketij akti administrativ e kundershkon ate ne Drejtorine e Apelimit Tatimor.

Drejtoria e Apelimit Tatimor me vendimin e saj Nr.28531/1 Prot, date 29.01.2015 ka vendosur lenien ne fuqi te aktit administrativ "Njoftim vleresimi per detyrimet tatimore" Nr.17831 Prot, date 29.09.2014 te Drejtorise Rajonale Tatimore Korçe.

Ne te tilla rrethana pala paditese i eshte drejtuar me padine objekt gjykimi kesaj gjykate.

Pala paditese pretendon se nuk e ka kryer kundravajtjen administrative per te cilen eshte denuar me gjobe nga pala e paditur. Pala paditese pretendon se nuk ka kryer asnje shitje produkti pa leshuar kuponin tatimor.

Pala paditese pretendon se nuk ka identifikim te numrit te kases fiskale te kontrolluar ne subjekt dhe nuk pershkruset asnje lloj veprimi nga ana e inspektoreve te verifikimit per te identifikuar oren kur eshte leshuar kuponi tatimor i fundit.

Pala paditese pretendon se njoftim vleresimi per detyrimet tatimore eshte nxjerre ne kundershtrim me proceduren e parashikuar nga ligji dhe per kete shkak eshte nje akt administrativ absolutisht i pavlefshem. Pala paditese pretendon se inspektoret e pales se paditur nuk jane paraqitur ne ambjentet e pales paditese, nuk jane identifikuar dhe nuk kane paraqitur asnje urdher pune. Gjithashtu pala paditese pretendon se inspektoret e pales se paditur nuk i kane derguar paraprakisht njoftimin per kontroll pales paditese.

Akti i konstatimit dhe procesverbali i gjobes nuk permban identitetin e punonjesit te pales paditese qe ka kryer kete kundravajtje administrative, nuk percaktohet identiteti i bleresit.

Procesverbali i gjobes nuk i eshte njoftuar perfaqesuesit te pales paditese.

Nuk jane respektuar dispozitat e ligjit Nr.10279, date 20.05.2010 "Per kundravajtjet administrative" ne mbajtjen e procesverbalit te konstatimit te kundravajtjes administrative.

Ne te tilla rrethana pala paditese pretendon se akti administrativ njoftim vleresimi per detyrime tatimore i leshuar nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe eshte nje akt administrativ absolutisht i pavlefshem. Gjithashtu pala paditese pretendon se per te njejtat arsye i kundraligjshem eshte edhe vendimi

i Drejtorise se Apelimit Tatimor qe ka lene ne fuqi kete akt administrativ njoftim vleresimi per detyrime tatimore.

Pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Korçe ka prapesuar duke pretenduar se pala paditese e ka kryer kundravajtjen administrative te mosleshimit te kuponit tatimor dhe ne te tilla rrethana gjoba ne masen 200.000 leke e vendosur ndaj pales paditese per kete shkak eshte e ligjshme.

Gjate gjykimit rezultoi se inspektorët e pales se paditur kane kryer verifikimin ne teren te aktivitetit tregetar te pales paditese ne baze te urdherit te punes Nr.4478, date 06.09.2014. Pretendimi i pales paditese se nuk ka kryer shitje pa kupon tatimor eshte nje pretendim i pabazuar ne prova.

Pretendimi i pales paditese se nuk ka identifikim te numrit te kases fiskale te kontrolluar ne subjekt dhe nuk pershkruhet asnje lloj veprimi nga ana e inspektoreve te verifikimit per te identifikuar oren kur eshte leshuar kuponi tatimor i fundit, eshte nje pretendim i pabazuar qe nuk passjell si pasoje qe njoftim vleresimi per detyrimet tatimore te jete nje akt administrativ absolutisht i pavlefshem. Pretendimi i pales paditese se inspektorët e pales se paditur nuk jane paraqitur ne ambjentet e pales paditese, nuk jane identifikuar dhe nuk kane paraqitur asnje urdher pune eshte nje pretendim i pabazuar ne prova. Lidhur me pretendimin e pales paditese se inspektorët e pales se paditur nuk kane derguar paraprakisht njoftimin per kontroll pales paditese, gjykata cmon se ky pretendim eshte i pabazuar ne ligj, ne te kundert nuk do te kishte kuptim ky kontroll ndaj pales paditese ne baze te ketij urdheri pune.

Lidhur me pretendimin e pales paditese se akti i konstatimit dhe procesverbali i gjobes nuk permban identitetin e punonjesit te pales paditese qe ka kryer kete kundravajtje administrative dhe nuk percaktohet identiteti i bleresit, jane pretendime te pabazuara ne ligj dhe qe nuk passjellin si pasoje qe njoftim vleresimi per detyrimet tatimore te jete nje akt administrativ absolutisht i pavlefshem.

Lidhur me pretendimin e pales paditese se procesverbali i gjobes nuk i eshte njoftuar perfaqesuesit te pales paditese dhe nuk jane respektuar dispozitat e ligjit Nr.10279, date 20.05.2010 "Per kundravajtjet administrative" ne mbajtjen e procesverbalit te konstatimit te kundravajtjes administrative, gjykata cmon se eshte nje pretendim i pabazuar ne prova dhe ne ligj, sepse ky procesverbal gjobe i eshte njoftuar punonjesit te pales paditese qe eshte gjendur prezent, por ky i fundit ka refuzuar marrjen dijeni dhe se ne rastin konkret jane respektuar dispozitat e ligjit te

posaçem Nr.9920 "Per procedurat tatimore ne R.SH" dhe jo dispozitat e ligjit "Per kundravajtjet administrative", sikurse pretendon pala paditese.

Per keto arsye njoftim vleresimi per detyrimet tatimore eshte nje akt administrativ i ligjshem dhe i vlefshem po ashtu eshte vendimi i Drejtorise se Apelimit Tatimor qe ka lene ne fuqi kete njoftim vleresimi tatimor.

Per keto arsye padia e paditesit eshte e pabazuar ne prova dhe ne ligj dhe si e tille ajo duhet rrezuar nga gjykata.

Ne baze te nenit 45 te ligjit Nr. 49, date 03.05.2012 "Per Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative", ndaj ketij vendimi nuk lejohet ankim, sepse objekt kerkimi eshte kundershimi i akteve administrative qe permbajne detyrime ne te holla me vlere me te vogel se njezetefishi i pages minimale ne shkalle vendi. Paga minimale ne shkalle vendi me baze te V.K.M Nr.573, date 03.07.2013 eshte ne masen 22.000 leke, ndersa njezetefishi i saj eshte i barabarte me 440.000 leke.

PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te neneve 40, 41, 45 te ligjit Nr. 49, date 03.05.2012 "Per Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrveshjeve Administrative"

VENDOSI

1. Rrezimin e padise, si te pabazuar ne prova dhe ne ligj.
2. Shpenzimet gjyqesore jane ne ngarkim te pales paditese.
- Kunder ketij vendimi nuk lejohet ankim.
- U shpall sot me date 25.05.2015 ne Korçe.

SEKRETARE

MARINELA RUSHI



GJYQTAR

SOKOL IBI

